

KONTRATË SHIT-BLERJE

Më datë 04/04/2025 nga dhe ndërmjet palëve, lidhet kontrata e mëposhtme:

SHITËSI: Konstantinos Moula, i biri i Christoforos, lindur më 06.12.1950, në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me pasaporten me nr. AT0262931.

BLERËSI: Znj. Ela Puka, e bija e Kostandin-it, lindur me datë 19.09.1982, në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. 038203046.

Kushte të përgjithshme

- A. Shoqëria "Oksi-International" shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81905009H.
- B. Shitësi deklaron se zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, e barasvlefshme me 32 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 320,000 Lekë (treqind e njëzetë mijë).
- D. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit, dhe Blerësi dëshiron të blejë kuotën që Shitësi zotëron në shoqërinë "Oksi-International" shpk, të barasvlefshme me 32% të kapitalit.
- E. Përfundimisht, pas nënshkrimit të Kontratës së Shitblerjes, shoqëria "Oksi-International" shpk do të përbëhet nga katër ortakë, secili me nga një kuotë, si më poshtë vijon:
 - 1. Znj. Ela Puka, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate 1 (një) kuotë, e cila do të përfaqësojë 32% (tridhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, me vlerë 320,000 Lekë (treqind e njëzetë mijë).
 - 2. Znj. Ada Mulla, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate 1 (një) kuotë, e cila do të përfaqësojë 31.75% (tridhjetë e një pikë shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, me vlerë 317,500 Lekë (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind).
 - 3. Znj. Albana Hoxhaj, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate 1 (një) kuotë, e cila do të përfaqësojë 26.25% (njëzetë e gjashtë pikë njëzetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, me vlerë 262,500 (dyqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqindë) Lekë;
 - 4. Z. Ermir Avdaj, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate 1 (një) kuotë, e cila do të përfaqësojë 10% (dhjetë përqindë) të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, me vlerë 100,000 (njëqindë mijë) Lekë.
- F. Në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë "Oksi-International" shpk, nenin 73 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", pika 1, shkronja "b", të ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, hartohet kontrata e shitjes me kushtet si më poshtë:



Neni 1 **Objekti**

Shitja dhe Blerja e kuotës

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë mbi 32% (tridhjetë e dy përqind) të kapitalit që shitësi zotëron në shoqërinë "OKSI-International" shpk. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kapital, ndjekin këtë të fundit dhe kalojnë gjithashtu në favor të Blerësit.
- 1.2 Përfundimisht, pas nënshkrimit të Kontratës së Shitblerjes, shoqëria "Oksi-International" shpk do të përbëhet nga katër ortakë, secili me nga një kuotë, si më poshtë vijon:
1. Znj. Ela Puka, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate 1 (një) kuotë, e cila do të përfaqësojë 32% (tridhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, me vlerë 320,000 Lekë (treqind e njëzetë mijë).
 2. Znj. Ada Mulla, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate 1 (një) kuotë, e cila do të përfaqësojë 31.75% (tridhjetë e një pikë shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, me vlerë 317,500 Lekë (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind).
 3. Znj. Albana Hoxhaj, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate 1 (një) kuotë, e cila do të përfaqësojë 26.25% (njëzetë e gjashtë pikë njëzetë e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, me vlerë 262,500 (dyqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqindë) Lekë;
 4. Z. Ermir Avdaj, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate 1 (një) kuotë, e cila do të përfaqësojë 10% (dhjetë përqindë) të kapitalit të shoqërisë "Oksi-International" shpk, me vlerë 100,000 (njëqindë mijë) Lekë.

Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi kuotën

- 1.3 Blerësi do të bëhet zotërues me të drejta të plota të kuotës së blerë në shoqërisë "Oksi-International", menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

Neni 2 **Çmimi dhe Pagesa**

- 2.1 Çmimi i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e kuotës objekt kontrate është 320,000 Lekë (treqind e njëzetë mijë), çmim i cili do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në një nga llogaritë bankare të Shitësit.

Neni 3 **Të Drejtat dhe Detyrimet e Shitësit**

Shitësi deklaron dhe garanton se:

- 3.1 Shitësi është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i i kuotës që transferon te Blerësi, dhe ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje si dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësin se pjesa e kuotës objekt i kësaj kontrate është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.



3.3 Shitësi garanton Blerësin nga çdo pretendim që të tretët mund të kenë në lidhje me objektin e kësaj kontrate.

Neni 4

Të Drejtat dhe Detyrimet e Blerësit

4.1 Blerësi garanton se ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.

Neni 5

Të ndryshme

5.1 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë i mundur qëllimeve të palëve.

5.2 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

5.3 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.

5.4 Kushtet e përgjithshme janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e kontratës.

5.4 Gjuha e Kontratës: Kjo Kontratë është hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

PALËT

SHITËSI

Konstantinos Moula



BLERËSI

Ela Puka


Ela PUKA